

Takimi i Fakultetit Inxhinieria e Energjisë me Bordin Industrial

Rendi i ditës

1. Prezentimi i programit të studimit: **Inxhinieria e Energjisë~BSc**
2. Prezentimi i programit të studimit: **Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisi~MSc**
3. Të ndryshme

Takimi filloi pas përshëndetjes të pranishmëve nga **Dekani Prof..Ass.Dr. Armend Ymeri**, i cili poashtu i përshëndeti të pranishmit edhe në emër të Rektorit, Prof.Dr. Edmond Hajrizit.



Pas përshëndetjes, Dekani kaloi në prezentimin e fakultetit Inxhinieria e Energjise dhe proezentimin e programeve të lartëcekura. (foto 1)



Në vazhdim Dekani informoi të pranishmit se UBT ka bërë aplikimin në AAK për programin **BSc Inxhinieria e Energjisë**, ku bëri një prezentim të Korikules dhe shpërndarjen e lëndëve nëpër semestra si dhe ngarkesën e tyre në ECTS. Në vazhdim shpjegoi lëndët e parapara duke arsyetuar secilën lëndë të planifikuar në programin BSc +-Inxhinieria e Energjisë.

Pas prezentimit të Korikulës të porgramit **BSc Inxhinieria e Eenergjisë**, Dekani hapi diskutimin, ku fjalën e morën:

Driton Hyseni ~ Përfaqësues nga Termokosi, i cili pas falenderimit për ftesën shtroi disa çështje, të cilat i bazoi në nevojat e kompanisë Termokos për profilet e ndryshëm të Inxhinierëve dhe se shtroi pyetjen se:

1. Çfarë titulli merr studenti pas përfundimit të studimeve në nivelin BSc në programin **Inxhinieria e Energjisë** dhe mendon se emërtimi i programit është shumë i përgjithshëm, sepse energjia nuk nënkupton vetëm energjinë elektrike por edhe format tjera të energjisë. Shqetësimi i tij ishte se

legjislacioni ekzistues dhe Udhëzimi Administrativ i kufizon kompanitë publike gjatë shpalljes së konkurseve dhe për këtë arsye edhe ndodhin përsëritjet e konkurseve pasi që nuk po janë kompatibil me kërkesat e konkursit kandidatët.

Pyetjes iu përgjig Dekani se emërtimi i programit është bërë në bazë të specifikave të vendit tonë dhe në bazë të programeve të ngjashme në fakultetet e tjera ndërkombtare dhe se studenti pas përfundimit të studimeve merr titullin: **Bachelor i Inxhinierisë së Energjisë**. Pas përfundimit të studimeve studenti është i pajisur edhe me informata që kanë të bëjnë me fushën e makinerisë, ndërtimtarisë dhe informatikës të cilat janë të nevojshme për këtë profil të inxhinierit. Kurse Valbona Kadrija në bazë të përvojave të saj në KEDS, i propozoi përfaqësuesit të Termokosit që të e ndërrojnë Udhëzimin Administrativ dhe të mos shpallin konkurse në bazë të profilizimeve të vjetra, por duhet të bazohen me kërkesat e reja në treg dhe nga përvojat moderne.

Agron Orana ~ Profesor në pension dhe ekspert në fushën e Inxhinierisë së Energjisë, përshëndeti UBT-në për ftesën dhe mundësinë e shkëmbimit të përvojave duke menduar që lëndët nëpër semestra janë të qëlluara dhe në harmoni me kërkesat e kohës por pati dy rekomandime: e para që lënda **“Fundamentals of electrical engineering”** të emërtohet **“Basics of electrical engineering”** dhe tek lënda **“Basic of Electrical Machines”** të futen edhe disa kapituj në sillabus nga pjesa e Ngasjes dhe Tërheqjes.

Me propozimin e prof Agron Orana ishin në pajtim edhe të tjerë të pranishëm dhe morëm zotim që aq sa na japin mundësitë të mirren parasysh rekomandimet për këto dy lëndë.



Kjani Guri ~ përfaqësues nga Kompania KOSTT~ përshëndeti të pranishmit dhe mendon që lëndët nëpër semestra janë të qëlluara dhe në harmoni me kërkesat e kohës por shprehu mendimin se lënda që është e vendosur në semestrin e parë **“Siguria në punë”** të zhvendoset në semestra të mëvonshëm për arsye se studenti duhet të pajiset me informata tjera profesionale paraprakisht.

Përgjegjia nga Dekani ishte se për shkak çështjeve teknike është vendosur kjo lëndë në semestrin e parë, pasi që kjo lëndë i ka vetëm dy kredi, miërpo ka mundësi që gjatë studimeve të zhvendoset në semestrat në vijim.

Kadri Kadriu ~ Staf akademik në UBT, mori fjalën dhe argumentoi se emërtimi i fakultetit është kompatibil me kërkesat e kohës dhe se Inxhinieri i energjisë duhet të ketë njohuri edhe për fushat tjera inxhinierike madje edhe për aspekte ekonomike dhe ligjore. Kjo shifet edhe në kompanitë dhe institucionet ndërkombëtare ku programet e tyre trajtojnë edhe të dhëna nga këto fusha të inxhinierisë.

Përsëri fjalën e mori **Dekani Prof.Ass Armend Ymeri** ku pikërisht për këtë arsye është futr në semestrin e VI edhe Lënda :”Inxhinieria e Sistemeve”.

Luigj Imeri – Menaxheri i Operimeve në KEK Sh.A pasi mori fjalën përshëndeti të pranishmit dhe UBT-në për ftesën shprehu mendimi e emërtimet e lëndëve mbase janë të përgjithshme për disa specifika që hasën në industri por që këto pastaj plotësohen edhe me nivele më të larta të studimeve dhe një pjesë e tyre edhe me trajnime në vazhdimësi nga kompanitë që merren më fushën e inxhinierisë së energjisë. Gjithashtu u dakordua që ka mungesë edhe legjislacioni por që kompanitë janë të detyruara që konkurset ti shpallin sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu shprehu edhe ai mendimin se duhet bërë ndryshime në udhëzimin administrativ ndoshta në shpalljen e konkurseve që paraqiten nga kompanitë publike.

Enver Ahmeti – Kompania MONTING, pasi përshëndeti të pranishmitë u shprehë fillimisht se kompanitë të gjitha kanë nevojë për kuadër të këtij profili dhe se qysh sot mund të i punësoj dy inxhinier të kësaj fushe dhe kërkoi nga ne ndonje rekomandim të ndonjë emri të studentit që ka përfunduar studimet. Diskutimin e vazhdoi me kërkesën për më shumë informata në lëndët: **Internship dhe Praktikë industriale**. Ai u shpreh se praktika është një pjesë e një rëndësie të veçantë për studentët dhe inxhinierët e rinjë dhe mundësi e mirë edhe e kompanive që të kenë mundësi të angazhojnë në punë.

Gjithashtu **Enver Ahmeti** ngriti edhe një qështje që të shiqohet mundësi që krahas studimeve studentët të përgaditen edhe për formën e aplikimit për punë dhe mënyrën e intervistimit nga kompanitë që paraqesin konkurse punësimi.

Në vazhdim fjalën e mori **Dekani** dhe ofroi sqarime për organizimin e lëndëve të praktikës ku Praktika në semestrin e IV do të jetë me vizita nëpër ondustri (kompani) për çka u pajtuan edhe të gjithë të pranishmit dhe se praktika në semestrin e VI sipas këshillave të ekspertëve ndërkombëtar është që studentët të kryejnë praktikën në kompani në kohëzgjatje të pandërprerë pre së paku 20 ditë. Gjatë kësaj periudhe studenti do të mentorohet nga ekspert të kompanisë dhe do të përgadisë një projektë për pjesën e praktikës së realizuar. Gjithashtu Dekani vazhdoi me sqarimin se prezentimi dhe projekti nga studentët bëhet para stafit akademik numri i të cilëve është i zgjeruar dhe gjithashtu në vlerësim do të merrë pjesë edhe mentori i studentit nga pjesa e industrisë ku është realizuar praktika. Përveq kësaj praktika organizohet në form të vizitave studimore edhe nëpër lëndë specifike dhe sipas rëndësisë nga bartësi i lëndës pra jashë planifikimit të praktikës nga lëndët e cekura më lartë.

Edon Hajdini – Përfaqesues nga Kompania SCHNEIDER ELECTRIC, shprehu falenderimin për ftesën dhe shprehu mendimin se përveq tjerash studentët kanë nevojë edhe të përgaditen gjatë studimeve për njohjen dhe aplikimin e softuerve për simulime të cilat janë më se të nevojshme dhe është kërkesë e kohës. Me ç'rast shprehu gatishmërinë e ofrimit të licensës për dy softuerë për UBT-në, gjegjësisht Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë.

Në vazhdim **Dekani dhe stafi** i pranishëm nga ana e Fakultetit treguan se UBT është e pajisur me softuer të ndryshëm siç janë: CAD-i, GIS, etj si dhe u prezentuan shkurtimisht edhe dobutë e platfoems EON-XR.

Agron Orana ~ Profesor në pension dhe ekspert në fushën e Inxhinierisë së Energjisë, shprehu mendimin se në kuadër të studimeve në nivelin BSc të mos anashkalohen edhe studimi i bazave konvencionale të energjisë sepsë Kosova ka potencial të lartë edhe për faktin se kriza e fundit energjetike bëri që disa shtete të kthehen përsëri në prodhimin e energjisë nga lëndët fosile siç është qymyri.

Përgjigjen e mori nga **Dekani** duke iu përgjigjur se këto burime mësohen në lëndën mësimore **“Fundamental Energy Sources”**.

Valbona Kadrijaj nga Kompania KEDS ~ Përshëndeti të pranishmit dhe se shprehu shqetësimin për mungesën e stafit Inxhinierik në KEDS, duke tregua që Kompania KEDS ka nevojë për Bachelor të diplomuar nga Fakulteti Inxhinieria e Energjisë.

Në përmbledhje pas diskutimeve sa i përket programit **BSc Inxhinieria e Energjisë**, **Dekani dhe stafi akademik i Fakultetit** morën zotime se do të kenë parasysh këshillat dhe sygjerimet nga të pranishmit dhe se do të vazhdojnë me takimet me çdo kompani veq e veq duke i përtirë memorandumet e bashkëpunimit dhe krijimin e memorandumeve të bashkëpunimit me kompanitë e reja.

Më tutje vazhdoi takimi me të pranishmit për nivelin e studimit **MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit**.

Dekani paraqiti se niveli MSc është emërtuar si Inxhinieria e energjisë dhe Mjedisit dhe filloi me prezentimin e lëndëve nëpër semestra.

Dekani prezantoi se viti i parë semestri-I- dhe -II- përbëhet nga lëndë të përbëra nga fusha e Inxhinierisë së energjisë dhe një numër i lëndëve që kanë të bëjnë me mjedisin.

Kurse semestri III dhe IV do të organizohet në dy oijentime:

1. Inxhinieria e Energjise
2. Inxhinieria dhe mjedisi

Driton Hyseni-Ngrohtorja Termokosi ~ i interesoi emërtimet e titullit që marrin studentët kur diplomojnë më këtë nivel studimi.

Dekani iu përgjig se varësiht cilin orientim zgjedhin ne semestrin e III, atyre pas diplomimit ne ekstraktine notave do te figurojne lendet e orientimit te zgjedhur, pro jo edhe kendet e orientimit tjetër.

Kadri Kadriu- staf akademik, propozi se Kompanitë publike komkurset duhet me i specifiku se cilat fusha të përafërta mund të konkurojnë dhe se nevojat e stafit për trajnime për fusha specifike në të gjitha kompanitë janë vazhdimisht të domosdoshme.

Dhe në përfundim të takimit **Dekani, Prof Ass.Dr. Armend Ymeri** duke falenderuar të pranishmit për prezencë u zotua që do të vazhdoj me takimet individuale me kompanitë, për të marrë edhe informata sa më konkrete për nevojat e industrisë si dhe për të vazhduar memorandumet e bashkëpunimit.

Duke ju falenderuar përzemërsishtë për prezencën dhe kontributin po mbylлим këtë takim me shpresën se së shpejti do të takohemi në takimet e radhës.





LISTA E PREZENCES

Takimi i Fakultetit Inxhinieria e Energjisë me Bordin Industrial

Nr	Emri dhe Mbiemri	Kompania	Nënshkrimi
1	Edon HAZDINI	SCHNEIDER Electric	
2	KJANI GURI	KOSTIT	
3	Rexhep Kujuni	KOSTIT	
4	Qer Ahmeti	MONTING	
5	Agon Othana	Personel	
6	Kadri Kerdreli	UBT	
7	Driton Hyseni	Termokos	
8	Luzi Jemeri	KER-STA	
9	Valbona Behrija	FEOS	
10	Arni ALIJE MAJ	REAS/UBT	
11	Iliriana Shoupi	Personel	
12	Sami Gasli	Personel	
13	Neksiu Krasniqi	UBT	
14	Arjeta Gasli	KOSTIT	+
15			

